

ANILA DODA

**LËVIZJET KUPTIMORE, MEKANIZMI GJUHËSOR NË TREGIMET
ALEGORIKE DIBRANE**

E folmja e Dibrës ka disa tipare dalluese nga e folmja e krahinave të tjera si nga ana formale (ndërtimi fonetik, morfologjik, leksikor, sintaksor etj.) por edhe nga ana kuptimore (semantike). Është e njohur alegoria dibrane në mexhelise (kuvende burrash) apo edhe në të folurën e zakonshme. Fjalët, shprehjet, mënyra se si ato lidhen e ndërthuren me njëra-tjetrën, shumështresëzimi kuptimor i mbushur me nëntekst, e bëjnë të folmen dibrane shumë të veçantë dhe origjinale. Për këtë arsye dibranët njihen për njerëz të urtë e të mençur, po aq sa trimat e luftëtarë. Alegoria ka lindur në kushte të caktuara historiko shoqërore. Ajo shpreh një fazë të lartë në zhvillimin intelektual të njeriut. Të folurit alegorik në Dibrë është një veçori e dialektit lokal, një stil i veçantë, i figurshëm e gjuhës popullore. Dibra ka një kulturë të thellë materiale e shpirtërore. Albanologët, turistët, udhëtarët diplomatët, politikanët, ushtarakët, shkrimtarët etj., që kanë udhëtuar apo jetuar në Dibrë dëshmojnë për intelektualitetin e fuqishëm të dibranit.

Është e njohur ajo që quhet “Loxha e Dibrës” dhe që është karakteristike për Luzninë dhe për fshatrat e Malësisë së Dibrës (poshtë Drinit) kryesisht në Çidhën, në Dardhë, në Reç, në Luzni, në Katër Grykë, në Grykën e Vogël, pa përjashtuar as vise të tjera të Dibrës. Është pikërisht loja e fjalës, e folura me nënkuptime alegorike që përbën një sistem më vete brenda dialektit dibran dhe që duhet një kod i veçantë për ta zbërthyer e kuptuar atë. Ky sistem kaq i përsosur i komunikimit që njihet edhe me emrin “Shkolla e Dibrës”, përbëhet nga një sërë rregullash e ligjesh, aq mirë të njohura nga dibranët autoktonë, dhe aq befasuese e të pakuptueshme për të ardhurit. Siç thamë, kjo shkollë do të kërkonte një studim më vete, gjë të cilën jam munduar ta prek në disa nga kapitujt e tjerë të punimit tim të doktoraturës, ku jam marrë me folklorin dibran, me epikën legjendare historike apo edhe në disa tekste dialektore të mbledhura në zona të ndryshme të rrethit të Dibrës.

Alegoria si një mekanizëm gjuhësor funksionon si një sistem i veçantë komunikimi¹. Është një metaforë e vazhduar, një përshkrim ose tregim që nuk duhet kuptuar fjalë për fjalë, siç është shprehur, mbasi fsheh një mendim tjetër.

Tregimet alegorike ishin pjesë përbërëse e jetës së popullit. Populli mblidhej për të zgjidhur probleme të rëndësishme ose në gëzime e jo thjesht për të treguar mesele. Ato hynin në bisedë në mënyrë të natyrshme. Bartësit e tregimeve alegorike ishin kryesisht pleq, por këtu nuk përjashtoheshin as moshat e reja. Midis tyre shquheshin disa individualitete të spikatura, si përçues të përvojës së

¹ Gj. Shkurtaç, *Etnografi e të folurit shqip*, Tiranë, 2004, f. 246.

përbashkët, të cilët kishin një repertor më të pasur meselesh dhe që ishin më të mprehtë e më të stërvitur për t'i improvizuar dhe shpjeguar ato. Në përgjithësi bartësit e tij ishin njerëz të pashkolluar, por me aftësi ligjëruese. Midis tyre kishte disa bartës të pakët që ishin bërë profesionistë të vërtetë në tregimin, shpjegimin e krijimin e meseleve.

Në zhvillimin e meseleve rol të madh kanë luajtur odat dibrane, gjithmonë të hapura për mikun. Në to biseda gjallërohej në forma metaforike. Meseletë² i edukonin njerëzit, veçanërisht brezin e ri, me tradita atdhetare dhe me virtyte të larta morale. Ato mprihnin gjykimin dhe zhvillonin mendimin e pavarur, shprehësinë e të folurit me nëntekst të fuqishëm dhe me ngarkesë emocionale, përsosnin kulturën e parashtrimit të mendimeve.

Tematika e tregimeve alegorike është shumë e gjerë dhe e larmishme, nuk ka sferë të jetës që ajo të mos rrokë, sepse ajo ka lindur dhe ka funksionuar në kushtet e një mungese të theksuar të arsimimit dhe të lirisë së fjalës. Preken të gjitha llojet e marrëdhënieve midis grupeve dhe shtresave të ndryshme duke zbritur deri tek marrëdhëniet familjare midis burrit dhe gruas, vjehrrës dhe nuses, babës dhe birit. Një vend të rëndësishëm zënë tregimet alegorike dhe çështja kombëtare. Të pasura dhe me nivel të lartë janë dhe ato tregime që pasqyrojnë probleme të mprehta politike, që pasqyrojnë marrëdhënie ekonomike, shtypjen dhe shfrytëzimin e njerëzve të thjeshtë, mënyrat e shkatërrimit ekonomik të fshatarëve të varfër, proceset e diferencimit ekonomik, antagonizmin shoqëror. Në mjaft prej tyre trajtohen probleme estetike dhe morale si: vendin që zë e drejta dhe e padrejta në shoqëri, e bukura dhe e shëmtuara, tragjikja dhe komikja etj.

Treguesit e tyre ishin mjeshtër për të gjetur çastin kur duhej meseleja. Biseda në odat dibrane bëhej e ngadaltë. Njerëzit i linin radhë njëri-tjetrit. Ai që e merrte fjalën, dëgjohej me vëmendje e respekt. Ndërprerja e bisedës, me përjashtim të ndonjë replike të shkurtër, nuk pëlqehet. Debati ishte i fortë dhe për probleme të rëndësishme, ai nuk bëhej i hapur. Me karakterin alegorik dhe me urtësinë e tyre meseletë ishin edhe shprehje e vetëpërmbajtjes dhe e drejtpeshimit shpirtëror të popullit në raste konfliktesh dhe situatash të vështira.

Përjasja e asaj që thuhet në mesele me atë që duhet nënkuptuar, duhet të jetë e plotë, e përkryer por jo e hapur. Megjithëse biseda bëhet e hapur, në prezencën e të gjithëve, përmbajtja e saj nuk kapet nga të gjithë të pranishmit. Fshtësia e komunikimit nuk është e njëjtë për të gjithë tregimet alegorike. Disa e kanë më të lartë shkallën e deshifrimit, disa më të ulët. Fshtësia e komunikimit përcaktohet nga faktorët artistikë, shoqërorë dhe politikë.

Populli nuk i lejonte banalitetet dhe vulgaritetet. Në asnjërën prej meseleve nuk kishte fyerje të drejtpërdrejta, sado që domethënia e tyre mund të ishte shumë therëse. Nuk lejohej veçanërisht fyerja e mikut, gjë që vështrohej si shkelje e rëndë e traditës dhe e normave kanunore. Meseletë mund të ishin fragmentare në një bisedë. Tregohej një prej tyre, dhe kur s'gjente përgjigje, nuk vazhdohej më me to. Por, meseletë mund të vazhdonin edhe për një kohë të gjatë në bisedë. Në

² Xh. Martini, *Perlat e Dibrës*, Kristalina-Kh, Tiranë 2008, f. 11, 19-24, 33.

këto raste ato përdoren si kompozime alegorike, si një e tërë që nuk ndahet. Për nga lënda me të cilën ndërtohen, tregimet alegorike i kemi prej dy tipesh.

Tipi i parë merr lëndën nga folklori. Në të shfrytëzohen legjendat, fabulat, anekdotat, përrallat, lojërat problemore, nganjëherë edhe proverbat. Lënda folklorike, përveç vlerave të mirëfillta, që ka, në mesele merr vlera të reja, ajo bëhet alegorike. Po lënda folklorike i nënshtrohet procesit të përpunimit dhe të përshtatjes. Kjo është një punë shumë e ndërlikuar. Që një anekdotë të kthehet në një tregim alegorik³, kërkohet mjeshtëri e lartë.

Nga anekdota ka mbetur vetëm tipari kryesor i këtij zhanri si një tregim i shkurtër realist me përmbajtje humoristike që kritikon një dukuri.

Për t'u kthyer në tregim alegorik, ajo i është nënshtrohet procesit të përshtatjes që shfaqet me këto dukuri: ajo ka fituar karakterin alegorik të përdorimit, aftësinë për t'u ndërtuar në bisedë dhe funksionin e veçantë në të, domosdoshmërinë e përshtatjes në rrethana të caktuara duke përcjellë mesazhin e denigrimit të njeriut të paafte që merr përsipër të bëjë diçka që nuk mund ta bëjë.

Pak a shumë këtij përpunimi dhe kësaj përshtatje i nënshtrohen edhe llojet e tjera folklorike kur vihen në shërbim të tregimeve alegorike.

Tipi i dytë i tregimeve alegorike është ai që e merr lëndën nga aktualiteti. Lënda e këtij tipi do më shumë mjeshtëri për t'u ngërthyer në tregimin alegorik, sepse ajo mund të merret si një bisedë krejt e zakonshme. Në këto raste nuk ka rëndësi vetëm krijimi i rrethanave, njohja e problemeve që shtrohen në bisedë, por edhe njohja e mirë e të pranishmëve, madje jo vetëm e tyre, por edhe e pjesëtarëve të tjerë të familjes. Rol të veçantë luan disponimi i bashkëbiseduesve, afria apo acarimi midis tyre, mënyrat që përdorin për t'i zgjidhur mosmarrëveshjet. Meseleja duhet treguar vetëm kur të jepet hapësira e nevojshme. Lidhja e asaj që thuhet, me atë që duhet nënkuptuar, duhet të jetë e plotë dhe e përkryer.

Po meseletë e këtij tipi janë, si të thuash, shumë tekanjoze. Ato në mjaft raste nuk duan shumë hapësirë për t'u ndërkallur në bisedë.

Në odat dibrane burrat qëndronin këmbëkryq, pa u mbështetur, me qëndrim dinjitoz. Kjo ishte shenjë kulture në të ndenjtur dhe në shenjë respekti për të gjithë vallen e burrave. Një qëndrim i shkujdesur nuk do të tolerohej dhe në ndonjë rast, mund të quhej fyes dhe mund të bëhej objekt kritike.

Vlerat gjuhësore

Tregimet alegorike dibrane kanë vlera të mëdha gjuhësore. Në to fjala përdoret me kursim të madh. Figuracioni është i pasur dhe nuk lidhet thjesht me përdorimin e figurave por me konceptin figurativ. Për nga ndërtimi tregimet alegorike karakterizohen nga ***elementë të larmishëm të komikes***. Në to kemi ***ironinë*** e lehtë dhe ***sarkazmën*** e hidhur, të qeshurën e përmbajtur dhe të përqeshurën therëse, gazin e trishtuar dhe ***humorin e këndshëm***. Prandaj në mjaft tregime alegorike krijohet një ***kontrast*** mes asaj që thuhet asaj që duhet të nënkuptohet. Në formën e ***antitezave***, pas forcës fshihet dobësia, pas mençurisë budallallëku, pas diturisë injoranca, pas humanizmit brutaliteti, pas parullave

³ H. Ndreu, *Tregime alegorike dibrane*, 1983, f. 11.

demokratike mjetet e diktaturës. Tekstet e tregimeve alegorike janë të shkurtra, kanë karakter të improvizuar dhe me përfundime logjike.

Dialogu është i shkathët, i kursyer, i zhdërvjellët. **Mendimi është i ngjeshur**, narracioni i vrullshëm dhe ka mjaft gjetje poetike. Brenda këtij zhanri janë kristalizuar disa **modele gjuhësore** që kanë ardhur duke u ngulitur e formësuar dhe janë kthyer kështu në një gjuhë specifike të meseleve. Dallojmë qartë: “*Na ishte një herë... Ni herë e një kohë... Ai i tha*”... Në mesele **nuk ka fjali ndërmjetëse** pothuajse fare. Aty dallohet qartë kush flet. Tregimet alegorike kanë një rëndësi shumë të madhe për pasurimin e gjuhës letrare kombëtare. Pasurojnë formën e saj të folur, por edhe letërsinë e kultivuar, gjuhën e veprës letrare kombëtare. Të folurit alegorik dallohet për gjetjet e shkëlqyera si në planin gjuhësor ashtu edhe shoqëror, ka një përshtatje të mahnitshme ndërmjet tregimit alegorik dhe momentit kur tregohet.

Tregimet alegorike dibrane nuk janë një zhanër i fosilizuar. Ato bëjnë një jetë të gjallë edhe në kohën tonë, zhvillohen duke iu përshtatur realitetit dhe fitojnë frymë bashkëkohore. Këtë e dëshmojnë krijimet e këtyre pesëdhjetëvjeçarëve të fundit. Tregimi alegorik në rrugën e tij të zhvillimit fiton tipare të reja për të përvetësuar artistikisht dukuri të kohës sonë. Akti i meseleve është treguar mjaft aktiv në luftë kundër veseve të ndryshme shoqërore, por ai ka vepruar edhe ndaj problemeve të mprehta politike.

Si përfundim themi se tregimet alegorike dibrane kanë lindur në kushte të caktuara historike shoqërore; ato kanë shprehur mençurinë dhe filozofinë e popullit, shijen dhe ndjenjën e tij estetike. Tregimet alegorike dibrane janë një zhanër me shumë vlera pozitive në thesarin e kulturës sonë popullore, prej të cilit mund të pasurohet kultura jonë kombëtare.